

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

« Blerje goma + pjese xhenerike , mirembajtje mjetesh »

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**3 547 600 (tre milion e peseqind e dyzet e shtate mije e gjashtëqind ) leke pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Librazhd ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c) Formularin e ofertës ekonomike.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**Sipas kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1.Xhiroja mesatare vjetore per nje periudhe maksimumi deri ne 3(tre) vitet e fundit financiare , duhet të ketë një vlerë te pakten 40 % te vleres se parashikuar te kontrates, pa perfshire vleren e TVSH-se, per te cilin duhet te paraqitet vertetim leshuar nga administrata tatimore. Kjo kerkese konsiderohet e permbushur nqs Operatoret Ekonomike arrijne vleren e xhiros minimale , ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar nga AK si me lart.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqiperise”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

**Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojte vertetesine e informacionit te paraqitur ne zbatim te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, te ndryshuar.**

### **2.3 Pervoja e ngjashme :**

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, OE duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses te nje ose disa kontrata te meparshme , të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Vlera e kërkuar për realizimet e mëparshme duhet te jete te minimalisht deri ne 20% e vlerës te kontrates qe po prokurohet dhe që janë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete OE duhet te paraqese si dëshmi për përvojën e mëparshme,

- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara . ( Per kontratat ne sektorin publik).
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën minimalisht 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

### **Aftesite teknike dhe profesionale**

2.3.2.Operatori Ekonomik te kete te punesuar te pakten 1 punonjes, me profesion mekanik, i pajisur me certificate profesionale per ushtrimin e kesaj detyre nga institucionet shteterore kompetente apo

institucione private te akredituara dhe te njohura ne RSH. Punonjesi/it te jete/te i/te siguruar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi per sigurimet shoqerore .

**Sqarim per ofertuesit** : Ne respektim dhe zbatim te **Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Per Prokurimin Publik ” neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”,i ndryshuar, neni 26 neni 39**, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake**, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 te VKM nr.285, date 19.05.2021, te ndryshuar. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do t’i kërkoje ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.**

2.3.3.Disponimi i te pakten nje pike servisi per mjetet e transportit, ne territorin e Bashkise Librazhd ne pronesi ose me qera , te pasqyruar ne ekstraktin historik ne QKB.

2.3.4. Deklarate që Operatori Ekonomik merr përsipër të realizojë furnizimin e mallrave dhe shërbimin e montimit të pjesëve të këmbimit /xhenerike, objekt prokurimi sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor dhe brenda afatit kohor të përcaktuar nga AK .

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që pjesët e këmbimit që do të përdoren për riparimin e automjeteve janë të reja dhe të prodhuara sipas standardeve të CE.

- **Shënim: Operatori Ekonomik , do të kryejë edhe shërbimin e montimit të pjesëve xhenerike apo vendosjen e gomave për mjetet e transportit të Bashkisë Librazhd dhe Njësive të saj Vartese sipas nevojës të AK.**

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nënnt 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë kapacitetet teknike dhe aftësitë profesionale në përbushjen dhe realizimin e kontratës, si edhe garantimin e cilësisë së produkteve objekt kontrate dhe realizimin në kohë të shërbimit.

#### **2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim.**

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

**Ne respektim të nenit 36, 37 të LPP-se në të gjitha rastet kur përmendet “marke” përfshihet termi “ekuivalent”.**

**Sqarim për ofertuesit :** Ne respektim dhe zbatim të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “ Për Prokurimin Publik ” neni 82 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ” Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 neni 39, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake**, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, të ndryshuar. **Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes së afatit të ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë**

**elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*Te dhenat e mëposhteme janë përgatitur nga komisioni i perlllogaritjes se vleres se fondit limit dhe hartimit te specifikimeve teknike.(bashkangjitur DST)*

**Shënim : Ne rastet kur citohet ne specifikimet teknike termi “marke” ose “ Cilesia e pare”, ky percaktim eshte i barasvlefshem me termin “ ekuivalente”.**

*NJESIA E PROKURIMIT*